



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 113, datë 15.05.2020

**PËR BASHKIMIN E PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE TË FILLUARA MBI
BAZËN E VENDIMEVE NR.19 DT.27.01.2020 DHE NR. 92 DT.10.04.2020 TË
KËSHILLIT**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “E”, të Kushtetutës, në nenin 48 pika 6 të Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 18 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe në nenin 189 të Ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, me propozimin e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin paraprak të kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme,

V E N D O S I:

1. Bashkimin e procedurave administrative të filluara mbi bazën e vendimeve nr. 19, datë 27.01.2020 dhe nr.92 datë 10.04.2020 të Këshillit.
2. Vlerësimi përfundimtar dhe renditja e katër kandidatëve të kualifikuar të jetë e vlefshme për plotësimin e të tre vendeve vakante, për prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të shpallura me vendimet nr. 19, datë 27.01.2020 dhe nr.92 datë 10.04.2020.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

GENT IBRAHIMI

